



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 4636/11 Prot

Elbasan më 05/10/2023

VENDIM

Nr 85 datë 05/10/2023.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin GUSHT 2023

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 10 datë 20.02.2023 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin GUSHT 2023, 105 familje me fond 267.820 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1114/1 Prot

Elbasan, më 06.10.2023

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.85, datë 05.10.2023 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Gusht 2023", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Majlinda PERRIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 4637 Prot

Elbasan më 05/10 2023

VENDIM

Nr. 86 datë 05/10/2023

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin GUSHT 2023

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 11 datë 20.02.2023 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **GUSHT 2023** gjithsej 273 familje me një fond prej 1.180.525 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Elvi Çuni

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala



4637/2
09.10.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1115/1 Prot

Elbasan, më 06.10.2023

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.86, datë 05.10.2023 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Gusht 2023 ", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Majlinda PËRRIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

Nr. 4638/prot.

Elbasan, më 25.10. 2023

VENDIM

Nr. 87 datë: 05.10.2023

Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Z. Ardjan Shefit Kotorri, banor në lagjen "Emin Matraxhiu", nr. 1 dhe dhënien e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan

Në mbështetje të: ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; VKB Nr. 190 datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2023" si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës;

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :


1. Miratimin e vlerës financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës së shtetasit **Z. Ardjan Shefit Kotorri**, në bazë të dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar, e cila është në shumën **44,863** (dyzetë e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët duke shtuar më pas vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi d.m.th. $89,726^1 \times 50\% = 44,863 + 162,000^2 = 206,863$ lekë.
2. Miratimin e fondit të dëmshpërblimit dhe dhënien nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **206,863** (dyqind e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë, për familjen e **Z. Ardjan Shefit Kotorri**, për dëmin e shkaktuar nga djegia në banesën e tij.
3. Burimi i financimit do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2023, e i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 190 datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2023".

¹ Vlera e dëmeve në banesë

² Vlera e dëmeve në orendi e pajisje

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK


Elvi Çuni

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK


Lotfi Lala

Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kunder _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur me datë ____ / ____ 2023

4638/4
19.10.23



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE
DHE KRIZAVE

Nr. 4116/3 Prot.

Elbasan, më 19.10.2023

Lënda: Konfirmim Akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Adresa: Lagja "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa, Elbasan

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e qarkut", pasi u verifikua dokumentacioni dhe ligjshmëria e aktit tuaj **Nr.87 datë 05.10.2023** "Për miratimin e vlerës financiare, 206.863 (dyqind e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së **Z.Ardjan Shefit Kotorri**, banor në lagjen "Emin Matraxhiu", nr.1 dhe dhënien e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Majlinda PERRIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

Nr. 4639/prot.

Elbasan, më 05.10. 2023

VENDIM

Nr. 88 datë: 05.10.2023

**Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Znj.
Fatime Gure Selimi, banor në lagjen "Emin Matraxhiu", nr. 1 dhe dhënien e
shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan**

Në mbështetje të: ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; VKB Nr. 190 datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2023" si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës;

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**


1. Miratimin e vlerës financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës së shtetasës **Znj. Fatime Gure Selimi**, në bazë të dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar, e cila është në shumën 95,901 (nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e një) lekë. Kjo vlerë është rezultat i 50% të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët duke shtuar më pas vlerën e preventivit në pajisje dhe orendi d.m.th. $191,803^1 \times 50\% = 95,901 + 120.000^2 = 215.901$ lekë.
2. Miratimin e fondit të dëmshpërblimit dhe dhënien nga Bashkia Elbasan, në shumën prej **215.901 (dyqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e një)** lekë, për familjen e **Znj. Fatime Gure Selimi**, për dëmin e shkaktuar nga djegia në banesën e tij.
3. Burimi i financimit do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2023, e i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 190 datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2023".

¹ Vlera e dëmeve në banesë

² Vlera e dëmeve në orendi e pajisje

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK


Elvi Çuni

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK


Lutfi Lala

Miratuar me _____vota

Vota Pro _____

Vota Kunder _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur me datë ____ / ____ 2023

1039/4
19.10.23



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE
DHE KRIZAVE

Nr. 1117 Prot.

Elbasan, më 19.10.2023

Lënda: Konfirmim Akti.

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Adresa: Lagjja "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa, Elbasan

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua dokumentacioni dhe ligjshmëria e aktit tuaj Nr.88 datë 05.10.2023 "Për miratimin e vlerës financiare, 215,901 (dyqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e një) lekë, të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Znj. Fatime Gure Selimi, banor në lagjen "Emin Matraxhiu", nr.1 dhe dhënien e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

Nr. 4640/11 prot.

Elbasan, më 05.10.2023

VENDIM

Nr. 89 datë: 05.10.2023

Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e banesës së Z. Petrit Ramazan Çikoja, banor në fshatin Griqan i Sipërm, Njësia Administrative Labinot Fushë dhe dhënien e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr.329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; VKB Nr. 190 datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2023" si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës;

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI

1. Miratimin e vlerës financiare të dëmshpërblimit, për dëmin e shkaktuar nga rrëshqitja e banesës së Z. **Petrit Ramazan Çikoja**, banor në fshatin Griqan i Sipërm, Njësia Administrative Labinot Fushë, prej **1.356.335 (një milion e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e pesë)**.
2. Kjo vlerë është rezultat i **50%** të vlerës së preventivit të dëmeve në banesë të hartuar nga ekspertët **2.712.670¹ x 50% = 1.356.335 (një milion e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë**.
3. Burimi i financimit do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2023, i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 190 datë 27.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2023".
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore (Drejtoria e Emergjencave Civile).
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK


Elvi Çuni

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK


Lutfi Lala

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kunder _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur me datë ____ / ____ / 2023

¹ Vlera e dëmeve në banesë



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE
DHE KRIZAVE

Nr. 1118/3 Prot.

Elbasan, më 19.10.2023

Lënda: Konfirmim Akti.

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Adresa: Lagjja "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa, Elbasan

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u verifikua dokumentacioni dhe ligjshmëria e aktit tuaj Nr.89 datë 05.10.2023 "Për miratimin e vlerës financiare, 1.356.335 (një milion e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë e pesë) lekë, të dëmeve shkaktuar nga rrëshqitja e banesës së Z.Petrit Ramazan Çikoja, banor në fshatin Griqan i Sipërm, Njësia Administrative Labinot Fushë dhe dhënien e shpërblimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI



Majlinda PERRIU



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4690/11 Prot.

Datë 05.10.2023

VENDIM

NR. 90 DATË 05.10.2023

MBI

“Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë të vitit 2023”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2023, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë të vitit 2023”, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, pika 1, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.22, date 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”,

VENDOSI :

1. Të miratoje “Raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë të vitit 2023”, për Bashkinë Elbasan, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

SEKRETAR
Elvi Cuni

KRYETAR
Lutfi Lala

P.Sekt.Buxhetit: M.Beluli
Dr.Buxh.Fin.: A.Merkja
D.P.P.A.B.F: Q.Tusha
D.P. Sh. O: D. Meta
D.P. Sh. O: A.Lulaj
D.P.Sh..I: S.Mehmeti
Dr.Juridike: A.Hoxha
ZV/Kryetar: A.Bylykbashi



7

BASHKIA ELBASAN

4690
25.09.2023

**RAPORT MONITORIMI
BUXHETI 2023**

PROGRESIV 4- MUJORI II-të



SHTATOR 2023

Përmbajtja:

Buxheti i Bashkisë për vitin 2023 4 Mujori i II-të

Realizimi i të ardhurave të Bashkisë nga burimet e veta vendore për vitin 2023 4 Mujori i II-të

Realizimi i buxhetit për vitin 2023 4 Mujori i II-të

- F1. Funkzioni “Shërbime të përgjithshme publike”
- F2. Funkzioni “Shërbime të huamarrjes vendore”
- F3. Funkzioni “Rendi dhe siguria publike”
- F4. Funkzioni “Çështje ekonomike”
- F5. Funkzioni “Mbrojtja e mjedisit”
- F6. Funkzioni “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit”
- F7. Funkzioni “Shëndetësia”
- F8. Funkzioni “Argëtimi, kultura dhe feja”
- F9. Funkzioni “Arsimi”
- F10. Funkzioni “Mbrojtja Sociale”

I. BUXHETI I BASHKISË PËR VITIN 2023 4 Mujori i II-të

Detajimi i buxhetit për vitin 2023 4 Mujori i II-të është bërë bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.10296, date 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017, datë 27.4.2017 “Per financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin Nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023“ si dhe VKB nr. 190, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkise Elbasan per vitin 2023.

Programi Buxhetor i vitit 2023 parashikon një mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime publike cilësore me qëllim përmirësimin e jetesës së qytetarëve; përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale; përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta; mirëmbajtjen e tregjeve të reja; përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit; mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimin të biznesit; mbrojtjen e tokave bujqësore, rehabilitimin dhe investimin e infrastrukturës bujqësore; mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij; sigurimin e kushteve sa më dinjitoze për fëmijët dhe të rinjtë; mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit; zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive; sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan.

Zbatimi i Buxhetit të vitit 2023 është një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së jetës, përmirësimin e aksesit, integrimin territorial dhe barazinë në shërbime, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e cilësisë së jetesës dhe mbrojtjen e mjedisit duke e kthyer Elbasanin në një qendër të përparuar social-ekonomike.

Ky dokument ka përcaktuar 26 programe (21 programe që përdorin njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe që janë pjesë e buxhetit të Bashkisë Elbasan dhe 5 programe i takojnë fondeve nga trasfertat e kushtëzuara) dhe një seri funksionesh dhe aktiviteteve respektive për çdo funksion, prandaj është treguesi më i mirë se si shpenzimet e planifikuara lidhen me veprimtaritë dhe projektet e planifikuara si dhe me Strategjinë e Zhvillimit që i mbështet këto projekte.

Bashkia Elbasan, administron dhe menaxhon fondet, sipas 26 programeve të miratuara, si më poshtë:

1. Programi “Planifikim, Menaxhim & Administrim”
2. Programi “Shërbimet e Gjendjes Civile”
3. Programi “Shërbime të Policisë Vendore”
4. Programi “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile”
5. Programi “Mbeshtetje per zhvillimin ekonomik”
6. Programi “Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore...”
7. Programi “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”
8. Programi “Administrimi i pyjeve dhe kullotave”
9. Programi “Rrjeti Rrugor Rural”

10. Programi "Transporti publik"
11. Programi "Menaxhimi i mbetjeve"
12. Programi "Planifikimi urban vendor"
13. Programi "Strehimi"
14. Programi "Shërbimet publike vendore"
15. Programi "Furnizimi me ujë dhe kahalizime"
16. Programi "Shërbimet e kujdesit parësor"
17. Programi "Sport dhe argëtim"
18. Programi "Zhvillimi i sportit"
19. Programi "Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore"
20. Programi "Arsimi bazë (përfshirë parashkollor "
21. Programi "Arsimi mesëm përgjithshëm (+ konvikte)"
22. Programi "Kujdesi social"
23. Programi "Strehimi social"
24. Programi "Emergjenca civile"
25. Programi "Zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore"
26. Programi "Fondi rezerve dhe kontigjenca"

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2023, vijnë nga dy drejtime:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga tarifatat vendore, të ardhura të tjera, donacione, dhe të ardhura të trashëguara.

Nga burimet qendrore, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta specifike për funksionet e reja (sektoriale), transferuar Bashkisë, transferta të kushtëzuara dhe investime nga FZSH.

II. REALIZIMI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË NGA BURIMET E VETA VENDORE PËR VITIN 2023 4 MUJORI I II-të

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, të ardhurat të tjera dhe të ardhurat nga funksionet specifike, si shërbimi pyjor, ujitja dhe kullimi, etj. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Gjatë periudhës janar-prill 2023, përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, Bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve.

Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efikasitet të aseteve të veta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimit nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të Bashkisë.

Objektivat sipas programit të kryetarit të bashkisë, kryesisht të fokusuar në lehtësimin maksimal fiskal, ndikuan në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Gjithashtu mundësimi i shlyerjes së pagesave sa më pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpërmjet strukturave të bashkisë dhe agjentit tatimor Ujësjetës Kanalizime të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit, ndikuan në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin.

Politikat për gjendjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqesore, etj. janë zbatuar dhe kanë rezultuar të sukseshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por edhe për rritjen e të ardhurave krahasuar me të njëjtën periudhë të viteve të kaluara.

Këto politika të lehtësive fiskale kundrejt përmirësimit të shërbimit janë shoqëruar natyrisht me objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Masat që u ndërmorën nga qeveria në mbrojtje të shëndetit të qytetarëve bënë që gjatë këtij viti të kishte përmirësime në vijimin normal të procesit të arkëtimit të të ardhurave dhe niveli i arkëtimit të ishte në rritje.

Të ardhurat e veta u realizuan në proces dhe bashkëpunim me gjithë administratën e Bashkisë, me Njësitë Administrative, me institucionet si agjentë tatimorë, institucionet shtetërore etj. Ndërsa periudha shkurt pati një ulje të nivelit të të ardhurave krahasuar me muajin janar, edhe në dy muajt e tjerë pasardhës reflektohet e njëjta tendencë. Muaji mars pati rritje të nivelit të arkëtimit krahasuar me muajin shkurt ndërsa në prill kemi përsëri ulje të nivelit të të ardhurave krahasuar me muajin mars, siç edhe tregohet në grafikun më poshtë.

Në planifikimin e të ardhurave për vitin 2023 janë përfshirë dhe të ardhurat nga arkëtimi i detyrimeve të prapambetura "Arkëtim debitorë", detyrime të cilat i takojnë familjarëve dhe arkëtohen nëpërmjet UKE si agjent tatimor, si dhe debitorë të mbartur në vite taksa dhe tarifa për subjektet.

Detyrimet e arkëtuara gjatë katërmujorit të parë nëpërmjet UKE për familjarët janë të evidentuara dhe janë në shumën 48,992 mijë lekë ose 61.2% e planit 4 mujor.

Përsa i takon arkëtimeve të prapambetura nga subjektet, meqenëse nuk është e mundur të merret informacion nëpërmjet sistemit të taksave, për këtë arsye ato janë të përfshira në faktin e të ardhurave të arkëtuara për periudhën Janar-Gusht 2023 së bashku me detyrimet për taksat dhe tarifatat e këtij viti.

➤ KATEGORIZIMI I TË ARDHUARAVE

Taksat vendore:

- Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
- Taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier
- Taksa e tabelës për qëllime reklamimi ose identifikimi
- Tatimi thjeshtuar mbi fitimin, biznesi vogël nga 5 milion deri në 8 milion,

Taksat e ndara:

- Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë,
- Taksa vjetore e mjeteve të përdorura,
- Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare
- Të ardhura pjesore nga tatimi mbi të ardhurat personale

Tarifatat vendore:

- Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
- Tarifa për ndriçimin publik
- Tarifa për gjelbrimin
- Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Elbasan

- Tarifa për parkimin e mjeteve e liçensuara dhe vendparkime publike
- Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri
- Tarifa për zënien e hapësirave publike
- Tarifa nga Institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.

Të ardhura të tjera:


- Të ardhura nga gjoba
- Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve, zhdëmtime, shitja e aseteve dhe e shërbimeve etj.

Të ardhura nga huaja:

- Të ardhurat nga burimet e veta të Bashkisë për 2023 4 Mujori i II-të (në mijë lekë)

N r.	Të ardhurat nga burimet e veta vendore	Plani 4 Mujori i II-të 2023	Fakti 4 Mujori i II-të 2023	Realizimi %
1	Të ardhurat nga taksat	440,288	183,757	42%
2	Të ardhura nga taksat e ndara	79,676	77,287	97%
3	Te ardhurat nga tarifat	303,573	251,518	83%
4	Te ardhura te tjera	404,839	122,109	30%
5	Te ardhura nga donacionet	0	2528	
	TOTALI	1,228,376	637,199	52%


Të ardhurat e realizuara sipas kategorive 4 Mujori i II-të 2023



- ▣ Te ardhurat nga taksat vendore
- ▣ Te ardhura nga taksat e ndara
- ▣ Te ardhurat nga tarifat vendore
- ▣ Te ardhura te tjera
- ▣ Te ardhura nga donacionet (jasht limiti)

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht
64831	56853	60861	53942	76011	81438	125954	117309

Paraqitja grafike:



Nr	Te Ardhura	PLAN VJETOR	Plan 4 Mujori i II-të 2023	Fakt 4 Mujori i II-të 2023	Krahasimi ne% me 4 Mujori i II-të 2023	Krahasimi ne % me planin vjetor
	TE ARDHURA	2023				
B	TE ARDH.VENDORE (I+II+III+IV+V+VI)	1,824,433	1,228,376	634,671	52%	34.79%
I	TE ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	660,182	440,288	183,757	42%	28%
1	Tatimi thjeshtuar mbi fitimin e BV	3,000	2,000	1,008	50%	34%
2	Taksa mbi ndertesat	223,062	148,800	105,244	71%	47%
3	Taksa mbi token bujqesore	27,480	18,400	9,315	51%	34%
4	Taksa mbi truallin	36,840	24,560	19,235	78%	52%
5	Taksa mbi veprimtarine e sherbimit hotelier	8,500	5,664	2,742	48%	32%
6	Taksa e ndikimit ne infrastrukture	360,000	240,000	43,324	18%	12%
7	Taksa e tabelës	1,300	864	2,889	334%	222%
II	TE ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	119,500	79,676	77,287	97%	65%
1	Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise	15,000	10,000	3,520	35%	23%
2	Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	70,000	46,680	52,474	112%	75%
3	Taksa e rentes minerare	500	332	309	93%	62%
4	Tatimi mbi te ardhurat personale	34,000	22,664	20,984	93%	61.72%
III	TE ARDHURA NGA TARIFAT	455,463	303,573	251,518	83%	55%
1	Tarife per zenien e hapesires publike	32,500	21,600	22,161	103%	68%
2	" pastrimi	167,000	111,200	104,958	94%	63%
3	" gjelberimi	34,000	22,720	22,517	99%	66%
4	" ndricimi	65,000	43,350	25,819	60%	40%
5	" mirembajtje infrastrukture ne Nj.Admin.	4,000	2,666	2,294	86%	57%
6	" reklame	8,000	5,340	4,599	86%	57%
7	" parkim automjete	20,000	13,333	10,592	79%	53%
8	" embleme bashkie	60	60	53	88%	88%
9	" leje, certificate transporti	2,000	1,340	1,709	128%	85%
10	" autorizim treg. karburanti + lende djegese	9,000	6,000	12,320	205%	137%
11	" leshimin e vertetimeve	2,283	1,522	1,088	71%	48%
12	" autoriz., zgjatje orari ,etj	2,200	1,466	1,517	103%	69%
13	" sherbimi karrotresh	500	334	3	1%	1%
14	" leje perdorimi per objekte biznesi	24,500	16,320	620	4%	3%
15	" leje perdorimi per banim	2,200	1,466	1,086	74%	49%
16	" certifikim relievi	1,000	700	632	90%	63%
17	" deklarim paraprak	4,300	2,864	939	33%	22%
18	" trajt.fasades ndertesave	1,200	800	1,440	180%	120%
19	" aplikim leje zhvillimi	1,500	1,000	350	35%	23%
20	" hartim PDV per siperfaqen e pronës	22,000	14,670	699	5%	3%
21	" shqyrtim dokumenta leje ndertimi	3,000	2,000	1,856	93%	62%
22	" kantier ndertimi per objekt mbi 4 kat	5,500	3,680	2,540	69%	46%

23	"	leshimin e dok.nga arkiva	200	134	40	30%	20%
24	"	rrjetin e tubacion.ujrave bardha	2,200	1,466	2,197	150%	100%
25	"	rrjetin e tubacion.ujrave zeza	290	192	283	147%	98%
26	"	sherbimi per rrjetin kabllor	4,000	2,670	2,874	108%	72%
27	"	uji pijshem	30	20	0	0%	0%
28	"	ndotjes mjedisit	19,000	12,660	18,629	147%	98%
29	"	depozitim i mbetjeve te ngurta	18,000	12,000	7,703	64%	43%
IV	TE ARDHURA JO-TATIMORE		243,443	177,292	32,706	18%	13%
1	Qera objekti		695	464	370	80%	53%
2	Qera trualli (toke e pafrytshme)		4,208	2,800	2,216	79%	53%
3	Qera toke bujqesore		310	208	140	67%	45%
4	Qera toke pyjore		21,270	14,180	18,274	129%	86%
5	Gjoha ndertimi		12,000	8,000	1,971	25%	16%
6	Gjoha biznesi		8,460	5,640	6,428	114%	76%
7	Te ardhura nga legalizimet		151,500	101,000	3,137	3%	2%
8	Te ardhura nga shitja e asetëve (FK)		45,000	45,000	0	0%	0%
9	Te ardhura nga shitja e tokes (troje,terrene)				82		
10	Te ardhura nga shitja ndertime				88		
V	TE ARDHURA INSTITUCIONET		73,185	45,778	32,555	71%	44%
1	Qendra Ekonomike Arsimit		52,535	32,070	20,265	63%	39%
	Te ardhura nga Cerdhet		11,616	6,971	4,120	59%	35%
	Te ardhura nga kopeshtet		32,718	19,632	11,244	57%	34%
	Te ardhura nga qerate		8,201	5,467	4,901	90%	60%
2	Te ardhura Klubi Shumesporte		1,030	688	837	122%	81%
	Te ardhura nga qira objekti		1,030	688	837	122%	81%
3	Qendra e Artit		900	540	394	73%	44%
	Te ardhura nga biletat		800	480	259	54%	32%
	Te ardhura okupim salle		100	60	135	225%	135%
4	Qendra e Trashegimise Kulturore		120	80	110	138%	92%
	Te ardhura Trashegimia Kulturore		120	80	110	138%	92%
	Te ardhura Biblioteka		0				
5	Agjensia e Sherbimeve Publike		10,600	7,060	6,152	87%	58%
	Te ardhura sherbimet publike		100	60	0		0%
	Te ardhura M.Varreza		9,000	6,000	5,727	95%	64%
	Tarife sherbimi per subjektet qe kryejne punime per riparimin e varreve		1,500	1,000	425	43%	28%
6	Te ardhura nga Banesat Sociale me Qira		8,000	5,340	4,797	90%	60%
	Te ardhura nga qirate		8,000	5,340	4,797	90%	60%
VI	TE ARDHURA FUNKSIONET SPECIFIKE		52,660	35,105	7,856	22%	15%
1	Te ardhura nga Zjarrfikesja		2,000	1,333	734	55%	37%
2	Te ardhura nga Sherbimi Pyjor		45,160	30,108	3,609	12%	8%
3	Te ardhura Ujitja dhe Kullimi		5,500	3,664	3,513	96%	64%

	ARKETIM DEBITORESH	220,000	146,664	48,992		
1	Arketimi i detyrimeve prapamb.2022(familje UKE)	120,000	80,000	48,992		
2	Debitorë të mbartur në vite (taksa-tarifa)	100,000	66,664			
	Te ardhura Jashte Limiti					
1	grant nga keshilli qarkut			2,400		
2	takse pulle gj civile			128		
	total j.limiti			2,528		
	Total te ardhura	1,824,433	1,228,376	637,199	52%	35%

Ne tabelën e mësipërme vërehet se të ardhurat vendore, periudhën 4 Mujori i II-të 2023 janë realizuar në masën 52% ose në vlerë totale 637,199 mijë lekë.

Nga këto të ardhurat nga taksat vendore janë realizuar në masën 42% ose në vlerë totale 183,757 mijë lekë.

Nga këto të ardhurat nga taksat e ndara janë realizuar në masën 97% ose në vlerë totale 77,287 mijë lekë.

Nga këto të ardhurat nga tarifat janë realizuar në masën 83% ose në vlerë totale 251,518 mijë lekë.

Nga këto të ardhurat jo tatimore janë realizuar në masën 18% ose në vlerë totale 32,706 mijë lekë.

Nga këto të ardhurat nga institucionet janë realizuar në masën 71% ose në vlerë totale 32,555 në mijë lekë.


Nga këto të ardhurat nga funksionet specifike janë realizuar në masën 22% ose në vlerë totale 7,856 në mijë lekë.

Në total, plani i të ardhurave për periudhën 4 mujori i II-të 2023 është realizuar në masën 52%.

➤ Të ardhurat e përgjithshme në total, nga burimet e veta vendore dhe burimet qendrore 2023 4 Mujori i II-të

Të ardhurat e përgjithshme në total, nga burimet e veta vendore dhe burimet qendrore 4 Mujori i II-të 2023		
1	Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore	634,670,413
2	Të ardhura nga donacione	2,400,000
3	Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar	839,574,471
4	Të ardhura nga transfertat sektoriale (specifike)	492,603,019
5	Të ardhura nga transfertat e kushtëzuar	1,920,210,522
6	Të ardhura të trashëguara nga viti 2021 (të ardh. veta + grante)	373,966,557
7	Huamarrja	2,321,516
8	TOTALI	4,265,746,498

Të ardhurat e përgjithshme në total 4 Mujori i II-të 2023



- ☒ Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore
- ☒ Të ardhura nga donacione
- ☒ Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar
- ☒ Të ardhura nga transfertat sektoriale (specifike)
- ☒ Të ardhura nga transfertat e kushtëzuar
- ☒ Të ardhura të trashëguara nga viti 2022 (të ardh. veta + grante)

Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore janë realizuar 634,670,413 lekë ose 15% e të ardhurave të përgjithshme.

Të ardhura nga donacione janë realizuar 2,400,000 lekë ose 0.1% të ardhurave të përgjithshme.

Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar janë realizuar 839,574,471 lekë ose 20% e të ardhurave të përgjithshme.

Të ardhura nga transfertat sektoriale (specifike) janë realizuar 492,603,019 lekë ose 12% e të ardhurave të përgjithshme.

Të ardhura nga transfertat e kushtëzuar janë realizuar 1,920,210,522 lekë ose 45% e të ardhurave të përgjithshme.

Të ardhura të trashëguara nga viti 2022 janë realizuar 373,966,557 lekë ose 9% të ardhurave të përgjithshme.

III. REALIZIMI I BUXHETIT VITI 2023 4 MUJORI I II-të

Realizimi i buxhetit të vitit 2023 është bërë duke respektuar ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, ligjin Nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023“ si dhe VKB nr. 190, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan per vitin 2023.

Shpenzimet e buxhetit për periudhën 4-Mujori i II-të 2023, nga të gjitha burimet e financimit, arritën në **2,828,759 mijë lekë**, me një nivel realizimi prej **51%**.

PROGRAMI	EMERTIMI	PLAN VJETOR 2023	FAKT 4 MUJORI I II-të 2023	REALIZIMI
01110	Planifikim, Menaxhim & Administrim	648,101	320,020	49%
01170	Sherbime te gjendjes civile	20,395	12,548	62%
03140	Shërbime të Policisë Vendore	33,200	20,351	61%
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	166,529	29,397	18%
04130	Mbeshtetje per zhvillim ekonomik	3,918	2,705	69%
04220	Shërbimet bujq., inspekt,sig.ushq dhe mbrojtja e konsumatorit	21,524	11,943	55%
04240	Menaxhimi infrastruktures Ujitjes& Kullimit	56,951	26,854	47%
04260	Administrimi i pyjeve +kullotave	112,431	28,717	26%
04520	Rrjeti rrugor rural	613,761	162,120	26%
04570	Transporti Publik	60,905	17,877	29%
05100	Menaxhimi i mbetjeve	248,716	132,078	53%
06140	Planifikimi Urban Vendor	7,026	0	0%
06190	Strehimi	46,286	18,998	41%
06260	Sherbime publike vendore	345,713	167,026	48%
06370	Furnizimi me uje dhe kanalizime	50,594	15,468	31%
07220	Sherbimet e kujdesit paresor	2,426	1,526	63%
08130	Sport dhe argetim	119,144	59,687	50%
08140	Zhvillimi i sportit	30,372	25,080	83%
08220	Trasheg.kulturore eventet artist.&kulturore	122,396	48,304	39%
09120	Arsimi baze¶shkollor	607,530	289,254	48%

09230	Arsimi Mesem Pergj. (arsimi mesem + konvikte)	421,548	154,970	37%
09240	Arsimi Mesem Profesional	40,615	37,107	91%
10430	Perkujdesi social	1,649,190	1,223,241	74%
10661	Strehimi Social	36,944	15,102	41%
10910	Emergjenca Civile	44,609	0	0%
01620	Zgjedhjet e pergjithshme & lokale	8,464	8,386	99%
04980	Fondi rezerve & Kontigjenca	20,000	0	0%
	TOTALI	5,539,288	2,828,759	51%


EMERTIMI	PLAN VJETOR 2023	FAKT 4 MUJORI I II-të 2023	REALIZIMI
Paga + sigurime (600+601)	1,266,330	801,044	63%
Shpenzime operative (602+651+166)	1,071,760	463,363	43%
Transferta (604+605+606+609)	1,819,378	1,245,934	68%
Investime (230+231)	1,381,820	318,418	23%
Totali	5,539,288	2,828,759	51%

Peshën më të madhe të realizimit në përqindje e zënë transfertat në masën 68% të planit ku përfshihen ndihmat ekonomike, pagesa e personave me aftësi ndryshe, financiar këto nga transfertat e kushtëzuar.

Një zë i rëndësishëm janë shpenzimet e personelit (paga dhe sigurime), të cilat janë realizuar në masën 63%, ku përveç pagave të administratës bëjnë pjesë edhe pagat e punonjësve të arsimit parashkollor (edukatorët e kopështeve), punonjësit e konvikteve, punonjësit mbështetës të arsimit

parashkollor dhe të mesëm, shërbimi zjarrfikës, ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave, etj, sipas funksioneve të cilat iu deleguan bashkive pas reformës territoriale.

Paraqitja grafike:



Bazuar në shpenzimet faktike të vitit 2023 :

Shpenzimet për paga zënë 28% të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar 62% me burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta, 38% me transfertë specifike dhe transfertë të kushtëzuar.

Shpenzimet operative zënë 16% të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar 97% me burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta, 2.6% me transfertë specifike dhe 0.4% nga te ardhurat jashte limiti.

Shpenzimet për transferime zënë 44% të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar 3% me transfertë të pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta dhe 97% me burim financimi transfertën e kushtëzuar.

Shpenzimet për investime zënë 11% të totalit të shpenzimeve dhe janë realizuar 54% me burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta, 44% me transfertë specifike, dhe 2% me burim financimi te ardhurat jashte limiti.

Realizimi i shpenzimeve për 4 Mujorin e II-të (progresive), viti 2023 (nga të gjitha burimet e fondeve)

Programi	Shpenzime personeli	Shpenzime operative				Transferta+ subvencione				Shpenzime Kapitale				në mijë lekë			
		plan		fakt		plan		fakt		plan		fakt		plan		fakt	
		plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt
1	Planifikim, Menaxhim & Administrim	01110	357,554	226,833	188,865	89,555	28,357	3,632	73,325	648,101	320,020						
2	Sherbime të gjendjes civile	01170	19,662	12,502	687	0	46			20,395	12,548						
3	Sherbime të Policisë Vendore	03140	30,110	20,261	3,000	0	90			33,200	20,351						
4	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	03280	37,767	22,028	7,310	2,230	103,663	960	17,789	166,529	29,397						
5	Mbeshtetje për zhvillim ekonomik	04130	3,318	2,105	600	600				3,918	2,705						
6	Sherbimet bujq., inspekt, sig. ushq dhe mbrojtja e konsumatorit	04220	13,200	8,819	200				8,124	21,524	11,943						
7	Menaxhimi infrastrukturës Ujitjes& Kullimit	04240	17,812	13,639	16,685	6,836	68	68	22,386	56,951	26,834						
8	Administrimi i pyjeve +kullotave	04260	21,390	14,044	43,317	708			47,724	112,431	28,717						
9	Rrjeti rrugor rural	04520	78,115	54,495	41,013	17,017	2,111	191	492,522	613,761	162,120						
10	Transporti Publik	04570	5,660	3,766	20,545	11,616	5,000	2495	29,700	60,905	17,877						
11	Menaxhimi i mbetjeve	05100	18,850	12,020	228,333	120,058			1,533	248,716	132,078						
12	Planifikimi Urban Vendor	06140							7,026	7,026	0						
13	Strehimi	06190					16,701	14,363	29,585	46,286	18,998						
14	Sherbime publike vendore	06260	61,270	44,970	230,149	100,690	371	231	53,923	345,713	167,026						
15	Furnizimi me uje dhe kanalizime	06370							50,594	15,468	15,468						
16	Sherbimet e kujdesit pasesor	07220	1,726	1,526	700					2,426	1,526						
17	Sport dhe argetim	08130	31,770	18,948	31,661	18,126	18,551	16,551	37,162	119,144	59,687						
18	Zhvillimi i sportit	08140							30,372	25,080	25,080						
19	Trashëg kulturore eventet artist.&kulturore	08220	47,070	30,887	38,546	17,389	50	28	36,730	122,396	48,304						
20	Arsimi baze¶shkollor	09120	387,951	224,908	121,479	46,207	1,768	1,127	96,332	607,530	289,254						
21	Arsimi Mesem Pergj. (arsimi mesem + konvikte)	09230	47,895	32,864	40,553	11,547	35	35	333,065	421,548	154,970						
22	Arsimi Mesem Profesional	09240			1,561		39,054	37,107		40,615	37,107						
23	Perkujdesi social	10430	73,692	46,623	38,926	15,065	1,533,842	1,161,047	2,730	1,649,190	1,223,241						
24	Strehimi Social	10661	3,790	2,085	16894	5,054	15,960	7963	300	36,944	15,102						
25	Emergjencia Civile	10910					33,711		10898	44,609	0						
26	Zgjedhjet e pergjithshme & lokale	01620	7728	7,721	736	665				8,464	8,386						
27	Fondi rezervë & Kontigjencia	04980					20,000			20,000	0						
	TOTALI		1,266,330	801,044	1,071,760	463,363	1,819,378	1,245,934	1,381,820	5,539,288	2,828,759						

Realizimi i shpenzimeve për 4 Mujorin e II-të, (progresive)viti 2023 (me fonde nga burimet e veta),grant+ transfert pakushtezuar sektoriale + ardhura														në mijë lekë	
Programi	Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta+ subvencione		Shpenzime Kapitale		Total buxheti					
		plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt				
1	Planifikim, Menaxhim & Administrim	01110	357,554	226,833	188,002	89,555	28,357	3,632	73,007	0	646,920	320,020			
2	Shërbime të Policisë Vendore	03140	30,110	20,261	3,000		90	90	0		33,200	20,351			
3	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	03280	37,767	22,028	7,310	2,230	103,663	960	17,789	4179	166,529	29,397			
4	Mbeshetje per zhvillimin ekonomik	04130	3,180	1,967	600	600					3,780	2,567			
5	Shërbimet bujq., inspekt.sig.ushq dhe mbrojtja e konsumatorit	04220	13,200	8,819	200				8,124	3124	21,524	11,943			
6	Menaxhimi infrastruktures Ujitjes& Kullimit	04240	17,812	13,639	16,685	6,836	68	68	22,386	6,311	56,951	26,854			
7	Administrimi i pyjeve +kullotave	04260	21,390	14,044	43,317	708			47,724	13,965	112,431	28,717			
8	Rrjeti rrugor rural	04520	78,115	54,495	41,013	17,017	2,111	191	492,522	90,417	613,761	162,120			
9	Transporti Publik	04570	5,660	3,766	20,545	11,616	5000	2,495	29,700		60,905	17,877			
10	Menaxhimi i mbeetjeve	05100	18,850	12,020	228,333	120,058			1,533		248,716	132,078			
11	Planifikimi Urban Vendor	06140							7,026		7,026	0			
12	Shërbime publike vendore	06260	61,270	44,970	230,149	100,690	371	231	53,923	21,135	345,713	167,026			
13	Furnizimi me uje dhe kanalizime	06370							50,594	15,468	50,594	15,468			
14	Shërbimet e kujdesit pasesor	07220	1,726	1,526	700						2,426	1,526			
15	Sport dhe argetim	08130	31,770	18,948	31,161	17,626	18,551	16,551	37162	6,062	118,644	59,187			
16	Trasheg.kult.eventet artist.&kulturore	08220	47,070	30,887	36,646	15,989	50	28	36730		120,496	46,904			
17	Arsimi baze¶shkollor	09120	387,951	224,908	111,066	36,997	1,768	1,127	86,379	11,102	587,164	274,134			
18	Arsimi mesem pergi(arsimi mesem + konvikte)	09230	47,895	32,864	37,790	8,784	35	35	140,621		226,341	41,683			
19	Perkujdesi social	10430	73,493	46,424	38,926	15,065	10,130	4,387	2,730	506	125,279	66,382			
20	Sprehimi Social	10661	3,790	2,085	16,894	5054	15,960	7,963	300		36,944	15,102			
21	Fondi rezerve & Kontigjenca	04980					20,000				20,000	0			
	TOTALI		1,238,603	780,484	1,052,337	448,825	206,154	37,758	1,108,250	172,269	3,605,344	1,439,336			

Shpenzime nga transferta e pakushtëzuar + të ardhurat për 4 Mujorin e II-të (progresive), viti 2023														në mijë lekë	
Nr	Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta+ subvencione		Shpenzime Kapitale			Total buxheti				
		plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt		
1	Planifikim, Menaxhim & Administrim	557,554	226,833	188,002	89,555	28,357	3,632	73,007		646,920		320,020			
2	Sherbime të Policisë Vendore	30,110	20,261	3,000		90	90			33,200		20,351			
3	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	5,028	100	710		103,623	920	2,000		111,361		1,020			
4	Mbeshtetje per zhvill. ekonomik	3,180	1,967	600	600			8,124	3,124	3,780		2,567			
5	Sherbimet bujq., inspekt, sig. ushq dhe mbrojtja e konsumatorit	13,200	8,819	200						21,524		11,943			
6	Menaxhimi infrastruktures Ujitjes& Kullimit	11,706	8,451	3,000	3,000	68	68	19,963	4788	34,737		16,307			
7	Administrimi i pyjeve +kullotave	8,070	3,514	41,317	200			47,724	13,965	97,111		17,679			
8	Rrjeti rrugor rural	62,709	43,682	35,329	12,628	2,111	191	492,522	90,417	592,671		146,918			
9	Transporti Publik	5,660	3,766	20,545	11,616	5000	2,495	29,700	0	60,905		17,877			
10	Menaxhimi i mbejeve	18,850	12,020	210,433	106,096			1,533		230,816		118,116			
11	Planifikimi Urban Vendor							7,026		7,026		0			
12	Sherbime publike vendore	61,270	44,970	230,149	100,690	371	231	53,923	21,135	345,713		167,026			
13	Furnizimi me uje dhe kanalizime							50,594	15,468	50,594		15,468			
14	Sherbimet e kujdesit paresor	1,726	1,526	700						2,426		1,526			
15	Sport dhe argetim	31,770	18,948	31,161	17,626	18,551	16,551	37,162	6,062	118,644		59,187			
16	Trasheg kult. eventet artist.&kulturore	47,070	30,887	36,646	15,989	50	28	36,730		120,496		46,904			
17	Arsimi baze¶shkollor	34,705	19,351	111,066	36,997	1,673	1,037	86,379	11,102	233,823		68,487			
18	Arsimi mesem pergj(arsimi mesem + konvikte)			25,355	6,546			95,045		120,400		6,546			
19	Perkujdesi social	57,160	33,585	33,286	11,252	10,130	4,387	2,730	506	103,306		49,730			
20	Strehimi Social	3,790	2,085	16894	5054	15,960	7,963	300		36,944		15,102			
21	Fondi rezervet & Kontigjenca					20,000				20,000		0			
	TOTALI	753,558	480,765	988,393	417,849	205,984	37,593	1,044,462	166,567	2,992,397		1,102,774			

Shpenzime nga transferta pakushtëzuar sektoriale për 4 Mujorin e II-të ,(progresive),viti 2023													në mijë leke	
Nr	Programi / Njesite Shpenzuese	Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta		Shpenzime Kapitale		Total buxheti			
			plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt		
1	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	03280	32,739	21,928	6,600	2,230	40	40	15,789	4,179	55,168	28,377		
2	Menaxhimi infrastruktures Ujitjes& Kullimit	04240	6,106	5,188	13,685	3,836			2,423	1,523	22,214	10,547		
3	Administrimi i pyjeve +kullotave	04260	13,320	10,530	2,000	508					15,320	11,038		
4	Rrjeti rrugor rural	04520	15,406	10,813	5,684	4,389					21,090	15,202		
5	Menaxhimi i mbejeve	05100			17,900	13,962					17,900	13,962		
5	Arsimi baze & parashkollor	09120	353,246	205,557			95	90			353,341	205,647		
6	Arsimi mesem pergj (arsimi mesem + konvikte)	09230	47,895	32,864	12,435	2,238	35	35	45,576		105,941	35,137		
7	Pekujdesi social	10430	16,333	12,839	5,640	3,813					21,973	16,652		
	TOTALI		485,045	299,719	63,944	30,976	170	165	63,788	5,702	612,947	336,562		

Shpenzime nga transferta e kushteuar për 4 Mujorin e II-të (progresive) viti 2023

Nr	Programi / Njesite Shpenzuese	Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta		Shpenzime Kapitale		Total buxheti	
			plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt
1	Bashkia Elbasan(QKR)	04130	138	138							138	138
2	Gjendje civile	01170	19,662	12,502	687	46	46	46			20,395	12,548
3	Strehimi	06190				16,701	14,363	14,363	4,635	4,635	46,286	18,998
4	Zhvillimi i sportit	08140							30,372	25,080	30,372	25,080
5	Arsimi bazë & parashkollor	09120			10,413	9,210					10,413	9,210
6	Arsimi mesem pergjithshem	09230			2,763	2,763			192,444	110,524	195,207	113,287
7	Arsimi mesem Profesional	09240			1,561		39,054	37,107			40,615	37,107
8	Ndihma ekonomike +PAK	10430				1,519,368	1,154,530	1,519,368			1,519,368	1,154,530
9	Viktimat e dhunes + projekte	10430				4,344	2,130	4,344			4,344	2,130
10	Emergjencia civile	10910				33,711		33,711	10,898		44,609	0
11	Zgjedhje te pergjithshme & lokale	01620	7,728	7,721	736	665					8,464	8,386
	TOTALI		27,528	20,361	16,160	12,638	1,613,224	1,208,176	263,299	140,239	1,920,211	1,381,414

Shpenzime nga te Ardhurat jashte Limiti për 4 Mujorin e II-të (progresive), viti 2023												
Nr	Programi / Njesite Shpenzuese	Programi	Shpenzime personeli		Shpenzime operative		Transferta		Shpenzime Kapitale		në mijë lekë	
			plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt
1	Planifikim, Menaxhim & Administrim	01110			863				318			0
2	Arsimi baze & Parashkollor	09120							9,953		5,910	5,910
3	Sport & Argetim	08130			500	500					500	500
4	Trasheg.kult.eventet artist.&kulturore	08220			1,900	1,400					1,900	1,400
5	Perkujdesi social	10430	199	199							199	199
	TOTALI	-	199	199	3,263	1,900	0	0	10,271	5,910	13,733	8,009

A) Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta vendore.

Këto burime të ardhurash zënë një vënd kryesor në buxhetin e bashkisë pasi financojnë pothuajse të gjitha funksionet në administrim të vetëqeverisjes vendore, të përcaktuara nga ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe përbëjnë 51% të totalit të buxhetit.


Gjatë vitit 2023, përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi në mënyre racionale burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e funksioneve bazike dhe veçanërisht atyre sociale.

Të dhënat ekonomike:

			000/lekë
Emertimi	Plan Vjetor 2023	Fakt 4 Mujori i II-të 2023	Realizimi %
Paga dhe Sigurime	1,238,603	780,484	63%
Shpenz. Operative	1,052,337	448,825	43%
Transferime	206,154	37,758	18%
Investime	1,108,250	172,269	16%
TOTALI	3,605,344	1,439,336	40%

Totali i shpenzimeve buxhetore të realizuara me burimet e veta, krahasuar me planin vjetor është 40%, ose ne vlerë 1,439,336 mije lekë. Pagat janë realizuar në masën 63%, ose ne vlerë 780,484 mije lekë. Shpenzimet operative janë realizuar në masën 43%, ose ne vlere 448,825 mije lekë. Transferimet janë realizuar në masën 18% ose ne vlere 37,758 mije lekë dhe investimet janë realizuar në masën 16%, ose ne vlere 172,269 mijë lekë

Paraqitja grafike:




Fondi rezervë në buxhetin vitit 2023 është planifikuar në shumën 10,000 mijë lekë, ndërsa fondi i kontigjencës 10,000 mijë lekë. Gjatë 4-mujorit II-të 2023 Fondi Rezervë nuk është përdorur.

Fondi i emergjencave civile, në buxhetin e vitit 2023 është planifikuar në shumën 103,623 mijë lekë, gjatë periudhës Janar-Gusht 2023 është përdorur 3% e fondit të emergjencave civile ose 3.153 mijë lekë.

Investimet nga të ardhurat dhe transfertat e pakushtëzuar:

Sipas detajimit të buxhetit dhe depozitimit në sistemin e Thesarit, janë planifikuar 110,129 mijë lekë nga transfertat e pakushtëzuar, 8,000 lekë nga transfertat sektoriale (specifike), 193,327 mijë lekë nga fondet e trashëguara nga viti 2022, nga të ardhurat e vitit 2023 janë 710,694 mijë lekë dhe të ardhura nga huaja 86,100 mijë lekë, gjithsej 1,108,250 mijë lekë.

Paraqitja grafike:



Rreth 64% e investimeve financohen nga të ardhurat e vitit, duke bërë që prokurimi dhe realizimi i tyre të varet shumë nga arkëtimi dhe realizimi i planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore. Rreth 17.4% të investimeve financohen me transfertë të pakushtëzuar dhe 0,7 % me transferte specifike. Të ardhurat e trashëguara financojnë rreth 10% të investimeve dhe 7.7 % zënë shpenzimet për shpronësime nga huaja.

Investimet (shpronësimet) nga huaja nuk janë realizuar për mungesë të dokumentacionit për shpronësim.

B) Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën specifike

Në vitin 2023 Bashkia vazhdon të kryejë funksionet e transferuara me burim financimi transfertën sektoriale (specifike). Funksionet që u transferuan në Bashki janë:

i. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar.

Në transfertën specifike të vitit 2023, janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Për arsimin parashkollor (kopshtet e fëmijëve, edukatorë dhe punonjës në qendrën kulturore të fëmijëve), janë alokuar fonde për paga dhe sigurime shoqërore për 252 punonjës të transferuar. Për punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjeçar (parashkollor dhe Qendra kulturore e fëmijëve) janë alokuar fonde për paga dhe sigurime shoqërore për 116 punonjës të transferuar.

i. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)

Në transfertën specifike të vitit 2023, janë alokuar fondet për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Në këtë fond bëjnë pjesë shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Numri i punonjësve është 35. Bashkia ka financuar nga të ardhurat e veta për rikonstruksion i godines të SMZSH-së, blerje kondicioner, stufë ngrohje me dru, kanal shkarkimi i ujerave të bardha për shumën 2,000 mijë lekë dhe nga granditë specifike financuar 15,789 mijë lekë.

ii. Administrimi i pyjeve

Në transfertën specifike të vitit 2023, janë planifikuar fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond përfshihen shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Për këtë funksion për vitin 2023 numri i punonjësve është 15.

Bashkia Elbasan në strukturën organizative të saj, ka krijuar Drejtorinë e Pyjeve, Bujqësisë, Veterinarisë dhe Mjedisit, në të cilën bën pjesë sektori i pyjeve, i cili merret me administrimin dhe mbrojtjen e pyjeve. Gjithashtu, meqënëse fondet nga transfertat sektoriale janë të pamjaftueshme për këtë shërbim, Bashkia Elbasan ka financuar nga të ardhurat e veta në zërin paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime, për të siguruar mbarëvajtjen e këtij shërbimi.

iii. Rrugët rurale

Në transfertën specifike të vitit 2023, janë alokuar fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Fondet e alokuara nga kjo transfertë janë të pamjaftueshme për të financuar të gjithë zërat e shpenzimeve të domosdoshëm për këtë funksion. Në këto kushte Bashkia Elbasan ka financuar nga të ardhurat e veta në zërin paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime, për të siguruar mbarëvajtjen e këtij shërbimi.

iv. Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën specifike të vitit 2023, janë planifikuar fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond perfshihen fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Për këtë funksion për vitin 2023 numri i punonjësve është 5. Ky shërbim është i atashuar në Agjensinë e Shërbimeve Publike, Sektori i Kullimit dhe Vaditjes. Për shkak të rëndësisë së veçantë që ka Ujitja dhe Kullimi, Bashkia Elbasan ka financuar nga fondet e veta si në shpenzime personeli, nëpërmjet punëtorëve sezonale, ashtu dhe në investime, për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e tokës.

v. Konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën specifike të vitit 2023, Bashkisë Elbasan i janë akorduar fonde për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë janë të përfshira: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzime operative dhe shpenzime për investime.

vi. Qendrat e Shërbimeve Sociale


Në transfertën specifike të vitit 2023 për Bashkinë Elbasan janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit dhe shpenzime operative për Qendrën Sociale “Balashe” Elbasan. Edhe në këtë rast Bashkia Elbasan ka financuar nga fondet e veta në shpenzime personeli, operative dhe investime.

Gjithashtu në këtë qendër kryejnë aktivitetin e tyre “Qendra Rome” dhe “Shtëpia e të Moshuarve”, të cilat Bashkia Elbasan i financon nga fondet e veta.

Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën specifike, në krahasim me planin vjetor rezulton të jetë **55%**. Pagat janë realizuar me **62%**, shpenzimet operative me **48%** dhe transfertat me **97%**. Realizmi investimeve në krahasim me planin vjetor është në masën **9%**.

Emertimi	PLANI VJETOR 2023	FAKTI 4 Mujorin e II-të 2023	000/lekë
			Realizimi %
Paga dhe Sigurime	485,045	299,719	62%
Shpenz. Operative	63,944	30,976	48%
Transferime	170	165	97%
Investime	63,788	5,702	9%
TOTALI	612,947	336,562	55%

Paraqitja grafike:



C) Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transfertën e kushtëzuar


Transferta e kushtëzuar përbëhet nga fondet e deleguara për mbulimin e shërbimit të Gjendjes Civile, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, fondet për mbështetje me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë dhe për personat me aftësi ndryshe, që në fakt zënë 85 % të totalit të transfertës së kushtëzuar ose 1,167,216 mijë lekë, si dhe fonde për bursat e nxënësve, bonuse strehimi, mbështetje për viktimat e dhunës të cilat zënë rreth 5 % të totalit të transfertës së kushtëzuar ose 65,431 mijë lekë. Zgjedhjet lokale zënë 0.6% të totalit të transfertës së kushtëzuar ose 8,386 Gjithashtu, pjesë e transfertës së kushtëzuar janë edhe investimet, të cilat janë në masën 11% ose 148,625 mijë lekë.

EMERTIMI	PLANI 2023	FAKTI 4 Mujori II 2023
QKR	138	138
Gjendja Civile	20,395	12,548
Trajtim ushqimor (bursat e nxenesve)	53,791	49,080
Bonus trehimi	16,701	14,363
Invaliditet+Paaftesia+Nd.Ekon	1,519,368	1,154,530
Viktimat e dhunes + projekte mbrojtjes sociale	4,344	1,988
Emergjencat civile	33,711	0
Zgjedhje te pergjithshme & lokale	8,464	8,386
Rikonstruksion i palestrave dhe terreneve sportive,Shkolla e Mesme e Bashkuar "Luigj Gurakuqi"	30,372	25,080
Permiresim I infrastructures kryesisht ne zona informale qe jane ne process legalizimi (Ndertim i linjes KUZ ne lagjen 5 Maj,rruga Arif Dardha dhe rruga Xhaferr Belegu, Rik.gjendjes ekzistuese te rruges "Arif Dardha")	29,585	4,635
Rikonstruksion i shkolles se mesme " Konstandin Kristoforidhi ",(rikonstruksion+ shtese anesore 4-kat dhe palester)	83,579	41,201
Rikonstruksion,shtese 4-kat dhe palester, Shkolla Artistike " Onufri" (e mesme e bashkuar)	94,014	69,323
Pajisje mobilerie per shkollat "Konstandin Kristoforidhi","Onufri" dhe "Hamit Mullisi")	14,851	0
Ndertim-i rrjetit te hidranteve per Krasten	10,898	0
TOTALI	1,920,211	1,381,272

Të dhënat ekonomike:

Emertimi	PLANI VJETOR 2023	FAKTI 4 Mujorin e II-të 2023	000/lekë Realizimi %
Paga dhe Sigurime	27,528	20,361	74%
Shpenz. Operative	16,160	12,638	78%
Transferime	1,613,224	1,208,176	75%
Investime	263,299	140,239	53%
TOTALI	1,920,211	1,381,414	72%

Paraqitja Grafike:



Në totalin e shpenzimeve, me burim financimi transfertën e kushtëzuar, realizimi për vitin 2023 4 Mujori i II-të, krahasuar me planin vjetor është **72%** ose **1,381,414** mijë lekë. Shpenzimet për paga janë realizuar në masën **74%**, transferimet ku bëjnë pjesë paaftësia dhe ndihma ekonomike në masën **75%**, Investimet janë realizuar në masën **53%**.

D) Shpenzime (investime) me të ardhurat nga huaja.

Një zë të vecantë në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të Bashkisë Elbasan zë huaja për shpronësime dhe investime në infrastrukturën rrugore, bazuar në marrëveshjen datë 29.09.2010, marrëveshjen e interceptimit nr.2544/1, datë 29.09.2010 dhe në aneks-marrëveshjen nr.751/1, datë 26.05.2014, lidhur midis Bashkisë Elbasan dhe BKT.

Shuma totale e huasë së miratuar, pas rishikimit, sipas aneks –marrëveshjes, është 711 milion lekë. Shuma e disbursuar gjithsej është 627 milion lekë, e cila është përdorur për shpronësime dhe pjesërisht për investime në infrastrukturën rrugore. Mbeten për disbursim 84 milion lekë, pjesë e buxhetit të miratuar për vitin 2023.

Sipas buxhetit të miratuar për vitin 2023, janë planifikuar të ardhura nga huaja 86 milion lekë dhe shpenzime për shpronësime dhe investime në infrastrukturën rrugore po 86 milion lekë. Gjatë katërmujorit të dytë të vitit 2023 është disbursuar shuma 2,3 milion lekë, mbeten për disbursim 84 milion lekë Disbursimi e kësaj shume është në varësi të plotësimit të dokumentacionit nga ana e ish pronarëve.

Nga shuma e huasë së disbursuar Bashkia Elbasan ka shlyer rregullisht këstet e shërbimit të borxhit (principal + interes), çdo muaj, bazuar në planin e pagesave të bankës.

Të dhëna mbi huamarrjen e Bashkisë Elbasan.

	Shuma	Shërbimi i borxhit të paguar deri më 31.08.2023			Shërbimi i borxhit për tu paguar deri në maturim		
		Principal	Interesa	Gjithsej	Principal	Interesa	Gjithsej
Hua e disbursuar	627,410	529,542	201,954	731,496	97,868	9,829	107,697
Hua pa disbursuar	83,737						
Gjithsej	711,147						

E) Programet kryesore në zërat e buxhetit.

i. Programi i Administratës Vendore (Planifikim Menaxhim, Administrim)

Programi i administratës vendore përcakton menaxhimin dhe mbështetjen administrative për programet e tjera të punës, veçanërisht në vazhdimësinë e zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në të gjitha nivelet e institucionit për të mundur përgatitjen, zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe kuadrit ligjor në funksion.

Qeverisja jonë lokale bazohet në parimet e sundimit të ligjit, përgjegjësisë, llogaridhënies, besimit, transparencës, efektivitetit, efikasitetit, partneritetit dhe koherencës.

Meqënëse qeverisja e mirë ndërlidhet me aftësinë e Bashkisë për të siguruar shërbimin më të mirë për komunitetin, çdo anëtar është aktiv për të dhënë kontributin e tij. Prandaj, për ne ekziston një nevojë e vazhdueshme që Bashkia të veprojë si lehtësuese duke iu prirë qytetarëve:

- drejt të menduarit strategjik,
- duke i përfshirë ata në çështjet e pushtetit lokal,
- duke i bërë partnerë në zgjidhjen e problemeve.

Politikat e vazhdueshme, të cilat do të zbatohen nga administrata e Bashkisë Elbasan, janë :

1. Një strukturë menaxhuese cilësore, duke krijuar mundësinë dhe lehtësinë për përthithjen e burimeve njerëzore profesionale dhe në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë Elbasan, për orfrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.
2. Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim krijimin ose përmirësimin e politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit mirëqenies së qytetarëve.
3. Dixhitalizmi i administratës publike është dhe do të mbetet një nga prioritetet tona në kuadër të programit të administratës vendore.

Ne jemi të angazhuar për të shtuar dhe promovuar shërbimet elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike vendore. Është realizuar ofrimi i shërbimeve administrative elektronike ndaj qytetarëve në Bashkinë Qendër dhe në Njësitë Administrative.

ii. Programi i Infrastrukturës Rrugore

Politikat e zhvillimit

Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe infrastrukturës rrugore rurale duke mundësuar akses më të mirë të tyre në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare. Programi i infrastrukturës rrugore, bazohet në 2 politika themelore:

1. Përmirësimin e mjedisit urban me standartet e duhura në shërbim të komunitetit.
2. Rritjen e cilësisë dhe sigurisë së jetës së banorëve.

Objektivat kryesorë të këtij programi janë:

1. Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore;
2. Përmirësim i infrastrukturës rrugore si dhe te rritje e aksesit ndaj shërbimeve bazë në zonat rurale.
3. Përmirësim i sigurisë në rrugët e Bashkisë së Elbasanit.
4. Mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrugëve, në pronësi të Bashkisë.
5. Reduktim i kostove për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes nëpërmjet rritjes së kapaciteteve teknologjike dhe përdorimit të fuqisë punëtore të njërive administrative.

Në buxhetin e vitit 2023, shpenzimet për investime në programin e Infrastrukturës Rrugore, Ujitjes dhe Kullimit dhe Shërbimet Publike Vendore zënë peshën më të madhe të totalit të buxhetit për investime, me rreth 41%, ose 562,632 mijë lekë. Ndërsa investimet për arsimin, ku përfshihen arsimit bazë, mesëm përgjithshëm dhe konviktet zënë 31% të totalit të buxhetit për investime ose 429,397 mijë lekë.

iii. Programet për Shërbimet Publike

Programi i ofrimit të shërbimeve publike qytetarëve, bizneseve dhe të gjithë komunitetit në të gjithë territorin administrative të Bashkisë përbën një nga kolonat kryesore të programit buxhetor.

Ky program përmban shërbimet më jetike për komunitetin siç janë:

- a) mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane,
- b) mirëmbajtja dhe administrimi i sipërfaqeve të gjelberta,
- c) mirëmbajtja e varrezave publike dhe krijimi i kushteve sipas standartave për shërbimin funeral,
- d) shërbimi i dekorit publik dhe ndriçimi i mjediseve publike,
- e) mobiliteti dhe transporti nëpërmjet krijimit të lehtësirave të lëvizjes, krijimin e kushteve për transportin publik,
- f) frealizimi sipas standarteve të sinjalistikës rrugore.

Shërbimet publike, për nga rëndësia e tyre, ndikojnë direkt në cilësinë e jetesës së qytetarëve dhe janë një parakusht për zhvillimin social ekonomik për të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan.

Programi i shërbimeve publike, bazohet në tre politika themelore :

1. Ofrimi i shërbimeve publike cilësore për përmirësimin e jetesës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit.
2. Rritja e efiçensës të teknologjisë si dhe zgjerimit të shërbimit nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm
3. Rritja e transparencës në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, duke siguruar pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit dhe të monitorimit, për ta orientuar atë sipas nevojave të tyre.

Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane

Përmirësimi i cilësisë së shërbimit, menaxhimi i mbetjeve të ngurta duke sunuar drejt ndarjes në burim të atyre të riciklueshme nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor që bën të mundur përmirësimin e situatës mjedisore dhe reduktimin e sasisë së mbetjeve që depozitohet në landfill. Në buxhetin e vitit 2023 ka një rritje të shpenzimeve për shërbimin e pastrimit, krahasuar me periudhat praardhëse, duke shtuar zonat e mbuluara me këtë shërbim por edhe

duke përmirësuar cilësinë e shërbimit të ofruar. Gjithashtu është parashikuar që kontrata e shërbimit të pastrimit të mbulohet 100 % me të ardhurat nga tarifa e pastrimit.

Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike

Përmirësimi i cilësisë së mirëmbajtjes dhe riorganizimi i lulishteve, zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe gjelbërimit rrugor në të gjithë Bashkinë.

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit të varrimit

Synohet për një shërbim cilësor me standarte sipas normativave dhe rregullores së mirëmbajtjes së varrezave nëpërmjet hartimit të një plani të integruar për funksionimin e Varrezave Publike. Gjithashtu synohet zgjerim i territorit të Varrezave Publike për vazhdimësinë e këtij shërbimi, nëpërmjet shpronësimeve. Nëpërmjet punonjësve të Agjencisë së Shërbimeve Publike është realizuar shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave në Njësitë Administrative.

Ndriçimi i mjediseve publike

Objektivat për këtë shërbim janë:

Përmirësimi i menaxhimit të shërbimit të ndriçimit

- a) Mirëmbajtje e ndriçuesve të zakonshëm ekzistues
- b) Mbajtja në efikasitet e ndriçimit të lulishteve ekzistuese.
- c) Mbajtja në efikasitet e ndriçimit rrugor
- d) Mirëmbajtja e gjithë rrjetit të ndriçimit rrugor.
- e) Ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së ndriçimit në 12 Njësitë Administrative dhe ndërtimi i linjave të reja me prioritet zonat e populluara.

Ndërhyrjet rehabilituese janë realizuar nga Agjencia e Shërbimeve Publike përgjatë gjithë vitit pasi është siguruar me pare baza materiale e nevojshme dhe janë hartuar projektet. Janë realizuar një sërë projektesh nga të cilët përmëndim : “Blerje ndriçues me gjithë krahë + kabell ABC”, “lidhje te reja energjie”, “Blerje shtylla ndricimi për linjat elektrike”, etj. Me rëndësi është të përmëndim kujdesin për ndricimin e qendrave të Njësive Administrative, projekt në vazhdim nga vitet e kaluara.

iv. Programi Mjedisi dhe Mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave

Pyjet kontribuojnë në mënyrë efektive në zhvillimin e qëndrueshëm, nëpërmjet sigurimit të mirëqenies njerëzore, sigurojnë një mjedis të shëndetshëm dhe mbështesin zhvillimin

ekonomik të zonës në tërësi. Potenciali unik i pyjeve mbështet një ekonomi të gjelbër, rrit cilësinë e jetës dhe ndikon në zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Sfida për të realizuar këtë balancë të qëndrueshmë mjedisore është e madhe dhe e vështirë referuar edhe larmishmërisë së territorit dhe problematikave që mbart secili sistem territorial.

Në buxhetin e këtij viti janë miratuar fonde për investime në shërbimin pyjor, për shtimin e sipërfaqeve të pyllëzuara, nga të cilat përmëndim:

- Hartim plane mbarështimi pyje e kullota;
- Investime në fondin pyjor (pyllëzime, përmirësime);
- Blerje pajisje matëse (busulla matëse).

Politikat e zhvillimit

Programi i Mjedisit dhe Mrojtjes së Pyjeve e Kullotave mbështetet në këto politika themelore :

1. Mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetareve, përmes bashkëpunimit me komunitetin e Bashkisë e shoqërisë civile. Rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit, gjithpërfshirjes në fushën e mbrojtjes së natyrës në bashkëpunim me të gjitha institucionet rajonale dhe jo vetëm, për ndalimin e humbjes së biodiversitetit por edhe përmirësimit të statusit të tyre.
2. Mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujrave sipërfaqësore, lumenjve dhe ujrave nëntokësorë, etj. Shfrytëzimin racional të burimeve ujore, shpërndarjen e drejtë të tyre sipas qëllimeve të përdorimit si edhe mbrojtjen e tyre nga ndotja.
3. Zhvillimin e qëndrueshëm dhe shumë funksional të burimeve pyjore dhe kullimore, që të sigurojnë ekuilibrin biologjik të ekosistemeve pyjore, ruajtjen e sipërfaqeve pyjore, rritjen e prodhimit dhe aftësisë ripërtëritëse të pyjeve, si dhe parandalimin e degradimit të mëtejshëm të tokës.
4. Realizimin e mbrojtjes së sipërfaqeve pyjore dhe kullimore nëpërmjet një qeverisjeje më të mirë të fondit për Administrimin e Pyjeve.
5. Hartim i projekteve teknike për pyllëzim të sipërfaqeve pyjore si dhe rehabilitim i sipërfaqeve pyjore dhe kullotë, të degraduara, djegura si edhe mbrojtja e tokës nga erozioni nëpërmjet investimeve për mbrojtjen e tokës.

v. Programi i Arsimit parauniversitar dhe edukimit

Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë. Shkolla duhet t'i mundësojë çdo fëmijë që të ketë rezultate të kënaqshme në mësim, të jetë i sigurtë, i shëndetshëm dhe aktiv në jetën komunitare.

Me ndarjen e re territoriale, Bashkia Elbasan duhet të sigurojë mirëmbajtjen e një numri të madh institucioneve arsimore për 12 njësitë administrative. Synimi ynë është menaxhimi me efikasitet i fondeve për arsimin dhe krijimi i mundësive për një zhvillim e shfrytëzim cilësor të infrastrukturës së institucioneve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Elbasan. Në kuadër të reformës së re administrative të qeverisjes vendore janë pjesë e këtij programi edhe delegimi i funksioneve të reja si: Arsimi parashkollor (kopshtet e fëmijëve), edukatorë dhe punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve, punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjecar, punonjësit e shërbimeve mbështetëse të arsimit të mesëm.

Politikat e zhvillimit:









1. Sigurimi i shërbimeve mbështetëse, cilësore në të gjithë territorin, për institucionet e edukimit parauniversitar dhe atij parashkollor gjatë procesit të realizimit të programit mësimor vjetor.
2. Mbështetja dhe promovimi i cilësisë së mësimdhënies dhe i rezultateve të larta në shkollë. Promovimi dhe nxitja e hapjes së strukturave të edukimit jashtë orarit mësimor, për të plotësuar një nga të drejtat bazë të fëmijëve, siç është argëtimi, loja, sporti etj.
3. Përmirësimi i kushteve dhe standarteve të shkollave nëpërmjet ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, për zhvillimin e procesit mësimor edukativ në kushte të përshtatshme në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë Elbasan.
4. Përmirësimi i shërbimit të ngrohjes me qëllim krijimin e kushteve për funksionimin dhe zhvillimin sa më normal të procesit mësimor.
5. Sigurimin e standarteve për sigurimin e higjenes për: konviktet, shkollat, kopështet, magazina, etj.
6. Përmirësimi i kushteve me anë të sigurimit të bazës materiale për shërbimet mbështetëse, me qëllim funksionimin sa më normal të objekteve shkollore (shkolla, kopështe, konvikte).

Rritja e sigurisë në ambjentet shkollore nëpërmjet shërbimit të rojeve të sigurisë publike dhe monitorimit me anë të sistemit të kamerave.

Përmirësimi i sistemeve të edukimit dhe trajnimit profesional dhe ndërlidhja e politikës arsimore me politikën social-ekonomike.

F) Detyrime të prapambetura

Stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të 4 Mujorit II-të të vitit 2023 arrijnë në vlerën, **133,582,223** lekë, kryesisht investime, shpenzime për mallra dhe shërbime dhe vendime gjyqësore. Stok i cili është parashikuar të shlyhet në Buxhetin e vitit 2023.

P.Sekt.Buxhetit:	M.Beluli	
Dr.Buxhet Financës:	A.Merkja	
D.P.P.A.B.F:	Q.Tusha	
D.P.P.ZH. U:	D. Meta	
D.P. Sh. O:	A.Lulaj	
D.P.Sh.I. P. P:	S. Mehmeti	
D.P.P.S.S.SH.K.T.I.M:	E.Muço	
D.P.P.A.P.T.K.T.S:	L.Dervishi	

**NËPUNËSI AUTORIZUES
ZV/KRYETAR**

Aulona Bylykbashi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHETËSE

Nr. 1119/1 Prot

Elbasan, më 10.10.2023

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.90, datë 05.10.2023 "Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë të vitit 2023", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Majlinda PERRIU





8

REPUBLICA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4691 Prot.

Datë 05.10 2023

VENDIM

NR. 91, DATË 05.10. 2023

MBI

“MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026, FAZA E DYTË”

Këshilli Bashkiak i Qytetit Elbasan, i mbledhur sot më datë 05.10.2023, pasi mori në shqyrtim materialet e përgatitura nga Bashkia e Qytetit Elbasan, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, “Mbi miratimin e fazës së dytë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.6, datë 28.02.2023 dhe nr.21, datë 07.07.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026”

VENDOSI :

1. Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, të rishikuar (faza e dytë), për Bashkinë Elbasan, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR
Elvi Çuni

KRYETAR
Lutfi Lala

P/Sekt.Buxhetit : M.Belëli

Dr.Buxh.Fin.: A.Merkja

D.P.Sh.M : Q.Tusha

D.P.SH.O : D.Meta

D.P.SH.I : S.Mehmeti

D.P. Sh. O: A.Lulaj

Dr.Juridike: A.Hoxha

Zv/kryetar : A.Bylykbashi



4681
25.08.2023

8



BASHKIA ELBASAN

**PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM
2024 - 2026**

1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR	4
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË	6
2. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË/QARKUT [EMRI] 2024-2026	8
2.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË ELBASAN NË VITET 2024-2026	9
2.1.2 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Elbasan për vitet 2024-2026	9
2.1.3 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Elbasan për periudhën 2024-2026.....	13

Lista e Tabelave

<i>Tabela 1. Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë Elbasan</i>	<i>8</i>
<i>Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit</i>	<i>10</i>
<i>Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.</i>	<i>14</i>
<i>Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike</i>	<i>17</i>
<i>Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike</i>	<i>21</i>
<i>Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit.....</i>	<i>22</i>
<i>Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
<i>Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
<i>Tabela 9. Të dhënat e Programit</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>

Lista e Shkurtimeve

PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV	– Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP	– Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	– Grupi për Menaxhimin Strategjik
MFE	– Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FPT	– Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT	– Instituti i Statistikave
PBB	– Produkti i Brendshëm Bruto

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjeçare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioritetëve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësinë vendore që të planifikojë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësinia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART¹. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë² (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare³, sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

¹ Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

² 'Afatgjatë' i referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

³ Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së. Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësi vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart⁴ i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MFE-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt

⁴ Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë për "Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.

planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2024-2026 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Taveve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT).

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MFE, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Për periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor njvqv-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin Plotësues të PBA-së). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së

2. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË ELBASAN 2024-2026

